



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 149/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.04.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

- Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Pura-Medical” ShPK në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-83461-12-30-2020, me objekt: “Shërbimi i Evadimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore” për Spitalin Sarandë, për 24 muaj”, me fond limit 6.779.880 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.
- Ankimues:** “Vale Recycling” ShPK.
Lezhë Kurbin, Fushë Kuqe, Gurëz, afër ish Kanalit të Acidit, Kurbin
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë
Lagjja Nr.3 Rruga Onhezmi, Sarandë
- Subjekt i Interesuar:** “Pura-Medical” ShPK
Ish Reparti i Kipit të Furnaltës, Kombinati Metalurgjik Elbasan
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.12.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-83461-12-30-2020, me objekt: “Shërbimi i Evadimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore” për Spitalin Sarandë, për 24 muaj”, me fond limit 6.779.880 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë

II.2. Në datën 18.01.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 03.02.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------|------------------------------|
| 1. “Pura Medical” ShPK. | 3.604.400 lekë, skualifikuar |
| 2. “Vale RECYCLING” ShPK. | 4.689.000 lekë, skualifikuar |
| 3. “Medi-Tel” ShPK. | 5.652.600 lekë, kualifikuar |
| 4. “Eco Riciklim” ShPK. | 6.779.880 lekë, kualifikuar |

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 16.02.2021 ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------|-----------------------------|
| 1. “Pura Medical” ShPK. | 3.604.400 lekë, kualifikuar |
| 2. “Vale RECYCLING” ShPK. | 4.689.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Medi-Tel” ShPK. | 5.652.600 lekë, kualifikuar |
| 4. “Eco Riciklim” ShPK. | 6.779.880 lekë, kualifikuar |

II.5. Në datën 16.02.2021 operatori ekonomik “Vale Recycling” ShPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Pura-Medical” ShPK duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...]Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë (AK) ka njoftuar në SPE më datë 31.12.2020 hapjen e procedurave për realizimin e shërbimit me objektin e mësipërm[...]. Megjithëse oferta jonë nuk rezultonte anomalisht e ulët AK Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë me anë të e-mail-it na ka dërguar shkresën nr. 99prot datë 27.01.2021 me lënë “Kërkohen sqarim për ofertë anomalisht të ulët”.

Më datë 02.02.2021 (afat ky i përcaktuar nga AK) i janë dërguar sqarimet narrative AK, analiza e detajuar e kostos së bashku me 15 dokumente provuese si fatura të ndryshme, kontrata pune, kontrata të ngjashme, leje mjedisore, taksa automjetesh, foto etj.

Më datë 03.02.2021 u njoftuam në SPE për rezultatet e vlerësimit të ofertave nga KVO si vijon:

- | | |
|----------------------------|------------------------------|
| 1. “Pura Medical” ShPK. | 3.604.400 lekë, skualifikuar |
| 2. “Vale RECYCLING” ShPK.. | 4.689.000 lekë, skualifikuar |
| 3. “Medi-Tel” ShPK. | 5.652.600 lekë, kualifikuar |
| 4. “Eco Riciklim” ShPK. | 6.779.880 lekë, kualifikuar |

Pas ankesës nga na jonë më datë 09.02.2021 më datë 16.02.2021 ora 18:46 jemi njoftuar në SPE për rezultatet e rivlerësimit të ofertave nga KVO si vijon:

- | | |
|-------------------------|-----------------------------|
| 1. “Pura Medical” ShPK. | 3.604.400 lekë, kualifikuar |
|-------------------------|-----------------------------|

- | | |
|---------------------------|-----------------------------|
| 2. “Vale RECYCLING” ShPK. | 4.689.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Medi-Tel” ShPK. | 5.652.600 lekë, kualifikuar |
| 4. “Eco Riciklim” ShPK. | 6.779.880 lekë, kualifikuar |

Ne i kundësjtojmë rezultatet e këtij rivlerësimi i cili duket hapur kundër shoqërisë “Vale Recycling” ShPK. për shkaqet dhe me argumentet në vijim:

1. OE “Pura Medical” ShPK nuk plotëson pikën 2.2 “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, gërma a):

Kopje të certifikuara/vërtetuara të bilanceve për vitet 2017/2018 dhe 2019 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore të konfirmuara nga ky autoritet.

Nga informacionet tona rezulton se shoqëria “Pura Medical” ShPK e renditur e para në këtë procedurë prokurimi nuk ka paraqitur bilancet e saj të konfirmuara nga autoritet tatimore (Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan)dhe ky përbën shkak për skualifikim sipas nenit 53/3 të RrPP-së[...]

Neni 46 pika 1 e LPP-së[...].

Dokumentet Standarde të tenderit pika II, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni I”Hartimi i Ofertës”, Pika 1.1 referojmë[...].

LPP dhe rregullat e prokurimit publik përcaktojnë qartë se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga autoriteti kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si dhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, pra nga gara, siç përcaktohet në paragrafin e fundit të shtojcës 8 të DST.

Për këtë arsye në zbatim të LPP dhe rregullave të prokurimit publik nuk mund kualifikohet një operator ekonomik në rast se ai ka paraqitur dokumentacion të paplotë sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Këto qëndrime të ligjit dhe të rregullave të prokurimit sa i takon trajtimin të kësaj çështjeje kanë rëndësinë e tyre të madhe për zhvillimin e një procedure konkurruese prokurimi, pasi ato janë garantë të zhvillimit të një gare të barabartë mes palëve(neni 2 i LPP-së).

Në rrethanat e mësipërme duke qenë se OE “Pura Medical” ShPK nuk ka paraqitur konfirmimin e bilanceve të saj nga autoritetet përkatëse, siç kërkohet në DST ndaj kjo përbën shkak për skualifikimin pasi vetë AK ka përcaktuar që bilancet e paraqitura nga OE përveç se të jenë të certifikuara e të vërtetuara duhet të jenë të konfirmuara nga ky autoritet.

Në konkluzion: Kërkojmë që “Pura Medical” ShPK të skualifikohet, pasi nuk përmbush pikën 2.2 të Kapacitetit teknik në lidhje me konfirmimin e bilanceve duke qenë se nuk ka paraqitur konfirmimin e bilanceve.

2. OE “Pura Medical” ShPK. nuk ka mundësi reale të justifikojë vlerën e ofertës anomalisht të ulët të paraqitur prej tij.

Duke e njohur mirë tregun dhe analizën e detajuar të kostove për realizimin e këtij shërbimi, ne kemi vëzhguar dhe studiuar edhe modalitetet me të cilat operon OE “Pura Medical” ShPK.

Nga këto vëzhgime, na rezulton se OE “Pura Medical” ShPK nuk ka kushte favorizuese si tonat në lidhje me elementët ekonomikë si p.sh. (i) vlerat favorizuese në furnizimin me materiale për shkak të rritjes së volumit të shitjeve (Pura Medical në fakt ka pësuar rënie në volumin e shitjeve, siç mund të shikohet të bilancet e depozituara dhe të pasqyruara në faqen ueb të QKR); (ii) nuk e bën servisimin teknik të automjeteve në stabilimentin e vet dhe me burimet e veta teknike dhe njerëzore por tek të tretë, çka i shkakton kosto më të larta se tonat; (iii)kostat e karburantit i ka

më të larta pasi ndryshe nga ne nuk ka bot dhe pikë furnizimi në stabilimentin e vet që mundëson përfitim të karburantit me çmim favorizues, nuk operon në fushën e mbetjeve urbane, duke pasur më pak burime të ardhurash, ka pak kontrata publike me spitale vetëm 1 realisht.

Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 e LPP-së rezulton se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik oferta e të cilit është konstatuar anomalisht e ulët nga KVO-ja. Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për të dhënë garanci si dhe bindjet autoritetit kontraktor. Së pari operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si dhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu OE duhet të argumentojë në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi si edhe mbi zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Sipas nenit 56 i LPP-së është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me plotësimin e katër kushteve të mësipërme të cilat janë kushte kumulative dhe argumentimi i secilit prej tyre duhet provuar nga OE përkatës me anë të provave shkresore dhe sqarimeve përkatëse.

Risku shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur, rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit kontraktor nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara, humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët, rrisht rritet në procedurën objekt prokurimi dhe nga fakti që është marrëveshje kuadër dhe sasia mund të jetë më e vogël nga sa është parashikuar, çka do të sillte mosmbulim të kostove nga OE dhe ndërprerje të shërbimit. Referojmë nenin 1 gërma b) të LPP-së[...] Bazuar në njohjet tona të këtij OE na rezulton se nuk mund të jenë paraqitur prova me të dhëna fakte apo garanci që të justifikojnë vlerën e ofruar prej këtij OE sipas kërkesave të nenit 56 të LPP-së[...].

Duke qenë se provueshmëria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e shërbimeve por për realizimin e tyre sipas standardeve të kërkuara në cilësi dhe sasi dhe me çmimin konkurrues të ofertuar. Bazuar në arsyetimin e shtjelluar më lart mendojmë se nga OE “Pura Medical” ShPK janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo bindës që të argumentojë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar).

Gjithashtu duke pasur parasysh faktin që është një marrëveshje kuadër dhe sasi të mund të jenë më të vogla nga sa janë parashikuar me ofertën e paraqitur nga “Pura Medical” ShPK jo vetëm që nuk mbulohet shërbimi për të gjithë sasinë. Në konkluzion Oferta e Pura Medical duhet të refuzohet pasi nuk krijon bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me garantimin e një kontrate të suksesshme.

Vlen të theksohet se AK në gjykimin tonë po bën çmos që “Vale Recycling” ShPK të mos jetë fituese e kësaj procedure prokurimi duke kulifikuar një shoqëri e cila ka mungesë dokumentacioni

dhe që nuk justifikon ofertën e saj ekonomike. Gjithashtu në DST në seksionin 4.2 është përcaktuar “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” çmimi më i ulët

Vlerësimi i procedurës në ofertë totale bie ndesh me përcaktimet e bëra nga ju në kushtet e përcaktuara nga ju ku është përcaktuar si kriter vlerësimi çmimi më i ulët për njësi, pra shumatorja e çmimeve për njësi.[...].

II.6. Në datën 25.02.2021, me shkresën nr. 310 prot, operatori ekonomik “Vale Recycling” ShPK. është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij.

II.7. Në datën 09.03.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 415 prot, datë 19.03.2021, protokolluar me tonën me nr. 406/4 prot, datë 23.03.2021, me objekt “*Informacion mbi procedurën e prokurimit*” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” ShPK. mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Pura Medical” ShPK. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: “2. OE “Pura Medical” ShPK. nuk ka mundësi reale të justifikojë vlerën e ofertës anomalisht të ulët të paraqitur prej tij. Duke e njohur mirë tregun dhe analizën e detajuar të kostove për realizimin e këtij shërbimi, ne kemi vëzhguar dhe studiuar edhe modalitet me të cilat operon OE “Pura Medical” ShPK. Nga këto vëzhgime, na rezulton se OE “Pura Medical” ShPK nuk ka kushte favorizuese si tonat në lidhje me elementët ekonomikë si p.sh. (i) vlerat favorizuese në furnizimin me materiale për shkak të rritjes së volumit të shitjeve (Pura Medical në fakt ka pësuar rënie në volumin e shitjeve, siç mund të shikohet të bilancet e depozituara dhe të pasqyruara në faqen ueb të QKR); (ii) nuk e bën servisimin teknik të automjeteve në stabilimentin e vet dhe me burimet e veta teknike dhe njerëzore por tek të tretë, çka i shkakton kosto më të larta se tonat; (iii)kostat e karburantit i ka më të larta pasi ndryshe nga ne nuk ka bot dhe pikë furnizimi në stabilimentin e vet që mundëson përfitimin e karburantit me çmim favorizues, nuk operon në fushën e mbetjeve urbane, duke pasur më pak burime të ardhurash, ka pak kontrata publike me spitale vetëm 1 realisht.” , Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se operatori ekonomik “Pura Medical” ShPK është njoftuar me anë të e-mailit lidhur me ofertën anomalisht të ulët ku autoriteti kontraktor i ka kërkuar sqarime mbi të në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e operatorit ekonomik “Pura Medical” ShPK me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

Shkresë datë 29.01.2021 me lëndë: “Sqarime për ofertën anomalisht të ulët” me përmbajtje si vijon:[...] Në lidhje me anën ekonomike dhe teknike të metodës së ndërtimit të ofertës së paraqitur sqarojmë se “Pura Medical” ShPK ka marrë në konsideratë këto elementë kryesorë:

Kosto e kontejnerëve njëpërdorimsh. Sasia e kësaj procedurë në total është një sasi prej 18.000 kg. Një kontejner njëpërdorimsh kartoni ose plastik me vëllim 40 litra që blihet nga shoqëria jonë bashkë me qesen shoqëruese të tij, kushton në çdo rast jo më shumë se 365 lekë. Vëmë në vëmendje që çdo kontejner mesatarisht mban 13 kg, dhe për këtë procedure nevojiten gjithsej 1385 kontejnerë dhe qese, që me koston e tyre në total arrijnë një kosto prej 505.525 lekë. (B. lidhur fatura e blerjes së kontejnerëve).

Kosto transporti të mbetjeve nga ambientet e AK në impiantin e OE pranë kombinatit metalurgjik Elbasan. Kjo kosto përbëhet nga kosto e karburantit të përdorur për këtë shërbim dhe kostot e pagave të punonjësve të transportit për këtë rast. Duke pasur parasysh se shërbimi

Në këtë rast është dy herë në muaj dhe kontrata e pritshme është deri në fund të 2023, rezulton se makina e transportit të shoqërisë do të bëjë rreth 48 shërbime transporti nga AK në vendndodhjen e impiantit të OE i cili është rreth 500 km vajtje-ardhje nga ambientet e spitalit Sarandë. Duke pasur parasysh çmimin mesatar të karburantit dhe se makina e transportit që do të bëjë shërbimin është me impiant gazi dhe kjo ulë ndjeshëm koston e karburantit (bashkëlidhur dokumentet e makinës AA627RZ). Duke marrë parasysh çmimin e gazit mesatarisht 50lejë/litër gjatë gjithë vitit makina konsumon 20litra LPG (gaz)/100 km. Pra kostoja nuk arrin më shumë se 1000 lekë për 100 km, rezulton se për këtë shërbim do të bëhen rreth 24000 km transport që në një mesatare do ti kushtojë OE një kosto prej 240000 lekë.

Kostoja e përpunimit të mbetjeve në impiantin e OE. Kjo kosto përbëhet nga kosto e lëndës së parë të impiantit, LPG për inceneratorin dhe energji elektrike për autoklavën, si dhe kosto e pagave të punëtorëve në këtë rast. Duke pasur parasysh sasinë dhe faktin që impianti ynë përpunon mbi 1 ton mbetje në ditë, rezulton se për përpunimin e kësaj sasive kërkohet maksimalisht 1 muaj, me gjithsej 34 procese autoklavë, rezulton se kostoja për një proces është 30000 lekë. Ndërsa inceneratori për sasinë tjetër kërkon rreth 30proçese pune, rezulton se kostoja për një proces është 1500 lekë. Në përfundim rezulton se kosto e autoklavës për sasinë 17100 kg është 1020000 lekë. Ndërsa duke pasur parasysh koston për inceneratorin për sasinë 900kg rezulton 45000 lekë në total.

Për këtë rast kërkohet edhe kosto e depozitimit të produktit të padëmshëm, pas përpunimit të tij. Sipas kontratës që ka shoqëria jonë në landfillin e Elbasanit prej 55 eurosh për ton, duke pasur parasysh që kjo sasi pas përpunimit reduktohet maksimalisht në 9 ton., rezulton që kosto e depozitimit të produktit përfundimtar në landfill të kësaj sasive nuk kalon vlerën e 60885 lekë.

Kostoja tjetër fikse në këtë rast është kosto e punonjësve të shërbimit të transportit dhe shërbimit të përpunimit në impiant për këtë rast. Që respektivisht rezultojnë në 2 muaj pune për dy punonjësit e transportit që rezulton kostoja 120.000 lekë dhe 1 muaj pune për 2 punonjësit në impiant që rezulton një kosto prej 60.000 lekë. Në total kostoja llogaritet për punëtorët shkon në 180.000 lekë. Në lidhje me zgjidhjen teknike të ofruar sqarojmë se “Pura Medical” ShPK ka një staf të gatshëm në çdo kohë për të bërë të mundur përmbushjen me sukses të detyrimeve. Kostot e stafit nuk janë të lidhura vetëm me këtë kontratë pasi stafi është i angazhuar dhe në zbatimin e kontratave të tjera me institucione publike private të cilat mbulojnë 100% shpenzimet e domosdoshme si paga, sigurime shoqërore, pagesat e tatimeve etj.

Çmimet e ofruara nga “Pura Medical” ShPK në këtë procedurë prokurimi janë në përputhje me çmimet e tregut edhe me procedura të tjera të zhvilluara së fundmi. Konkretisht:

Në procedurën e zhvilluar nga Spitali Universitar Shefqet Ndroqi në Tiranë në të cilën “Pura Medical” ShPK është shpallur fituese dhe ka filluar me zbatimin e kontratës është ofruar me çmime njësi të përafërta për referencë. Bazuar në analizën e mësipërme shumatorja e çmimeve për njësi në vlerën 1060 lekë pa TVSh dhe ofertë totale 3.604.000 pa TVSh përmbushin të gjitha elementët e kërkuar nga ligji për një ofertë të rregullt dhe i japin garanci AK-së për zbatimin me sukses të kontratës dhe çmim të leverdishëm. Bashkëlidhur do të gjeni:

Dokumentet e makinës AA627RZ

Faturën e blerjeve të kontejnerëve

Fatura të ngjashme

Formulari i ofertës me Spitalin Shefqet Ndroqi.

Mbetemi në dispozicion për çdo sqarim apo verifikim të mëtejshëm[...]

Faturë tatimore shitjeje nr. 363

Faturë tatimore shitjeje nr. 254

Faturë tatimore shitjeje nr. 179

Invoice nr. 2030375

Faturë tatimore shitjeje nr. 353

Formular i ofertës ekonomike datë 23.11.2020 (për Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi).

Tabelë për punonjësit (kategoritë).

Faturë nr. 2030376 datë 31.08.2020 (Isi Plast S.P.A)

Faturë nr. 310719 datë 23.07.2019

Faturë 310/19 datë 23.07.2019

Akt miratimi higjeno-sanitar nr.30 datë 08.09.2019 lëshuar nga Inspektorati shtetëror Shëndetësor Dega Rajonale Elbasan.

certifikatë pronësie e mjetit

Leje qarkullimi e mjetit në emër të “Pura Medical”

Siguracioni i mjetit

Taksa vjetore

Certifikatë e kontrollit teknik

III.1.5. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si:

rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i linden autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit 10 ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Pura Medical” ShPK në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Pura Medical” ShPK ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, por nuk ka paraqitur analizë kosto të detajuar që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se operatori ekonomik “Pura Medical” ShPK, ka paraqitur argumentimin të tij në formën e një sqarimi narrativ. Në këtë kuptim KPP gjykon se shpjegimi narrativ si dhe faturat tatimore të paraqitura nga operatori ekonomik ankimes nuk janë të mjaftueshme për autoritetin kontraktor për krijimin e bindjes se ankimesi disponon kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Operatori ekonomik ankimes ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues, që do të garantonin realizimin e shërbimit pranë autoritetit kontraktor. Gjithashtu nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar, nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e shërbimit në referim të germës ç, neni 56 pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi provueshmëria e këtij elementi/kushti është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e shërbimit por për realizimin e tij sipas standardeve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurrues të ofertuar. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i shërbimit të propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik ankimes “Pura Medical” ShPK nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “V.A.L.E Recycling” ShPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” ShPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Pura Medical” ShPK, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyesimit të K.P.P do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik “Pura Medical” ShPK., e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” ShPK për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-83461-12-30-2020, me objekt: “Shërbimi i Evadimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore” për Spitalin Sarandë, për 24 muaj”, me fond limit 6.779.880 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Pura Medical” ShPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” ShPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 406 Protokolli

Datë 09.03.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri